



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr.316/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi, kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Viti, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve KQZ, për shkak të ndërrimit dhe zëvendësimit me emra tjerë të anëtarëve dhe kryesuesëve të KVV-ve, për Zgjedhjet Lokale të 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

**V E N D I M**

**HIDHET** si e palejueshme ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Viti, për shkak të ndërrimit dhe zëvendësimit me emra tjerë të anëtarëve dhe kryesuesëve të KVV-ve.

**Arsyetim**

Me datën 23.10.2013, subjekti politik PDK dega në Viti, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën theksohet se duke u bazuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, nenin 75, mbi kualifikimin dhe kriteret e emërimit të anëtarëve dhe kryesuesëve të KVV-ve si dhe nenet 76 dhe 77 të këtij ligji, dega e PDK-së në Viti, ka caktuar dhe nominuar anëtarët dhe kryesuesit e KVV-ve, mirëpo në mënyrë joligjore këta anëtarë nga KKZ dhe nga KQZ-ja janë ndërruar dhe zëvendësuar me emra tjerë të cilët nuk janë përfaqësues të PDK-së në vendvotime. Parashtruesi i ankesës kërkon ndërhyrjen dhe emërimin e anëtarëve dhe kryesuesëve nëpër vendvotime të caktuara nga dega e PDK-së, në Viti e cila është dorëzuar në KKZ. Parashtruesi ka bashkangjitur ankesës listën e dorëzuar në KKZ.

PZAP-i, e informoi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 24.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij institucioni dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 25.10.2013. Sipas afatit të caktuar, PZAP-i, nuk pranoi përgjigjen e kërkuar nga KQZ.

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, dhe gjeti se:

## **ankesa është e palejuar**

Parashtruesi i ankesës subjekti politik PDK, në ankesën e tyre pretendon se në mënyrë jo ligjore është bërë ndërrimi dhe zëvendësimi me emra tjerë i anëtarëve dhe kryesuesve të KVV-ve, nga KKZ dhe KQZ-ja, të cilët nuk janë përfaqësues të PDK-së, në vendvotime. PZAP-i konstaton se këto pretendime ankimore nuk janë në juridiksionin e këtij institucioni për të vendosur sipas nenit 122.1 pikat a), b), c), d), e) dhe f) ngase PZAP-i, vendos vetëm për disa vendime të KQZ-së, të cilat përfshihen shprehimisht me dispozitën e sipërshtuar, meqenëse pretendimet ankimore nuk janë në përputhje me dispozitën e lart theksuar PZAP-i në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 316/2013 më datën 25.10.2013



**Kryesuesi i Panelit**  
**Nehat Idrizi**

**Këshillë juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.